

DHJETOR 2021  
PRISHTINË

Autor:  
Samir Shahini

FUQIZIMI I TË RINJVE  
NGA KOMUNITETET  
ROM, ASHKALI DHE  
EGJIPTIAN

[www.admovere.org](http://www.admovere.org)

Implementuar nga:



Mbështetur nga:



FUQIZIMI I TË  
RINJVE NGA  
KOMUNITETET  
ROM, ASHKALI  
DHE EGJIPTIAN

ADMOVERE  
(education |  
transitional justice |  
peacebuilding)

## REKOMANDIMET

- Të bëhen më shumë fushata vetëdijësuese në terren për rëndësinë e shkollimit të nxënësve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian,
- Të krijohet dhe mirëmbahet një rrjet i komunikimit në mes të trekëndëshit pedagogjik mësues – prind – nxënës, për të parë nga afër nëse nxënësit nga këto komunitete përballen me sfida gjatë shkollimit fillor apo të mesëm, qofshin ato sfida financiare apo të ndonjë natyre tjetër,
- Shkollat në bashkëpunim me drejtoritë komunale të arsimit t'i mbështesin me materiale shkollore nxënësit nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian,
- Shkollat të sigurojnë një ambient jodiskriminues, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë nxënësit pa marrë parasysh dallimet etnike, racore, gjinore e të tjera,
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) të shqyrtojë mundësinë për përkrahje financiare gjatë shkollimit universitar të të rinjve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian,
- Qendra e Studentëve bashkë me Menzën e Studentëve, t'i lirojnë nga pagesa të rinjtë e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian që udhëtojnë nga komuna tjera për të ndjekur shkollimin universitar,
- Universiteti i Prishtinës të shqyrtojë mundësinë për ofrimin e mësimëve në gjuhën rome, në ndonjë departament specifik, p.sh në Fakultetin Filologjik.

## ARSIMI I LARTË

Sa i përket arsimit të lartë, pjesëmarrja e komuniteteve joshumicë (Rom, Ashkali, Egjiptian, por edhe të tjera) është shumë e vogël. Shkaqet për këtë pjesëmarrje kaq të vogël janë të ndryshme, por më së shumti ka të bëjë me gjendjen socio – ekonomike. Duhet rikujtuar që Universiteti i Prishtinës (UP), si institucioni më i vjetër i arsimit të lartë në vend, parasheh kuota të rezervuara (12%) për studentët nga komunitetet joshumicë. Sipas një hulumtimi të organizatës Admovere, gjatë periudhës 2008 – 2020 në të gjitha fakultetet e UP-së janë paraparë 5,372 vende për komunitetet joshumicë. Pavarësisht, këtij numri, gjatë gjithë këtyre viteve, vetëm 18,42% e vendeve janë plotësuar me 990 studentë të pranuar nga komunitetet joshumicë. Vetëm 23.93% kanë diplomuar nga 990 sa janë pranuar. Pra, 237 studentë nga komunitetet joshumicë kanë diplomuar nga UP-ja për 12 vite<sup>3</sup>.

<sup>1</sup>Raport tematik «Vështirësitë që hasin nxënësit e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shkollim», hartuar nga Samir Shahini me mbështetjen e projektit «Iniciativa e Kosovës për Integrim KOSINT 2020» të financuar nga Fondacioni për Shoqëri të Haour, i zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në partneritet me Balkan Sunflowers (BSFK), Syri i Vizionit (SiV) dhe Roma and Ashkalia Documentation Center (RADAC), faqe 6. Qershor 2019, Prishtinë.

<sup>2</sup>Po aty.

<sup>3</sup>Raport «Përfshirja e studentëve të komuniteteve joshumicë në Universitetin e Prishtinës (UP)», Fitore Metbala&Aulonë Memeti, ADMOVERE, faqe 36. Dhjetor 2020, Prishtinë.

## SFIDAT E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOSOVË NË ARSIM

Ndonëse përshtypja e përgjithshme publike mund të jetë që gjendja e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë është e mirë, këto komunitete vazhdojnë të përballen me probleme të përditshme. Sfidat në arsim, në qasje në shërbimet shëndetësore, në punësim e të tjera, janë brenga e qytetarëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë në Kosovë.

## ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Pjesëmarrja e Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve në sistemin arsimor nuk është e kënaqshme. Këto komunitete vazhdojnë të jenë grupi më pak i përfshirë në arsimin fillor dhe shumë më pak i përfshirë në atë të mesëm dhe të lartë. Gjithashtu, fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptianë janë ata të cilët përbëjnë pjesën më të madhe të fëmijëve që ose kanë braktisur ose janë në rrezik braktisjeje<sup>1</sup>. Kujtojmë që në bazë të Ligjit, arsimi parauniversitar përfshin fëmijët e moshës 6 – 18 vjeç përgjatë tri niveleve: shkollës fillore (klasat 1 - 5), shkollës së mesme të ulët (klasat 6-9), shkollës së mesme të lartë (klasat 10 – 12/13), ku dy nivelet e para janë pjesë e shkollimit të obliguar<sup>2</sup>.